



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E SHËNDETËSISË

Nr. 4246/ _____ Prot.

Tiranë, më _____ 2016

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

[Data _____ 2016]

Për: BOE “BETA 80 S.p.a & INFOTEAM S.r.l & REALCOM Sh.p.k”, përfaqësuar nga Infoteam S.r.l (Massimo di Remiglio), Adresa: Infoteam S.r.l, Zyrë përfaqësimi në Durrës L. 8 Rr. “A. Goga”, Pall. 629, NIPT L42416503E.

* * *

Procedura e prokurimit: **“Furnizim vendosje pajisje kompjuterike, elektronike si dhe licencat për përdorimin e programeve të sistemit të integruar për shërbimin e ri kombëtar të urgjencës (Sistemi i integruar për shërbimin e ri kombëtar të urgjencës)” e hapur me mjete elektronike / mallra.**

Përshkrim i shkurtër i kontratës: **“Furnizim vendosje pajisje kompjuterike, elektronike si dhe licencat për përdorimin e programeve të sistemit të integruar për shërbimin e ri kombëtar të urgjencës (Sistemi i integruar për shërbimin e ri kombëtar të urgjencës)” me fond limit 196.071.000 (njëqind e nëntëdhjetë e gjashtë milionë e shtatëdhjetë e një mijë) lekë pa TVSH.**

Burimi i financimit: **Buxheti i shtetit:**

- Vlera 134.471.000 Lekë pa TVSH - Investime - Furnizim vendosje pajisje kompjuterike, elektronike si dhe licencat për përdorimin e programeve të sistemit të integruar për shërbimin e ri kombëtar të urgjencës (Sistemi i integruar për shërbimin e ri kombëtar të urgjencës)”.

Viti 2016 në vlerën 70.050.000 Lekë me TVSH, pjesa tjetër në vitet në vazhdim.

- Vlera 61.600.000 Lekë pa TVSH - Shpenzime - Mirëmbajtje SLA për 4 vjet.

(Për vitin 2016 janë vënë në dispozicion: 15.000.000 Lekë me TVSH - përcaktuar me shkresën nr. 10739/38prot, datë 09.08.2016 të Ministrisë së Financave, - pjesa tjetër në vitet në vazhdim)

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]JO

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. BOE “Regola S.r.l & FBS Sh.p.k & Communication Progress Sh.p.k” me përfaqësues Regola S.r.l, NIPT (kodi fiskal 06860880019) me vlerë 168,766,929 (njëqind e gjashtëdhjetë e tetë milion e shtatëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e nëntëqind e njëzet e nëntë) Lekë pa TVSH;

2. BOE "Beta 80 S.p.a. & Infoteam S.r.l & Realcom Sh.p.k" përfaqësuar nga Infoteam S.r.l NIPT L42416503E me vlerë 194,110,290 (njëqind e nëntëdhjetë e katër milion e njëqind e dhjetë mijë dyqind e nëntëdhjetë) Leke pa TVSH;

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. BOE "Regola S.r.l & FBS Sh.p.k & Communication Progress Sh.p.k", me përfaqësues Regola S.r.l, NIPT/ Kodi Fiskal 06860880019.

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

1. Regola S.r.l ka paraqitur vërtetim realizimi dhe faturë tatimore vetëm për shërbim menaxhimi dhe mirëmbajtje të sistemit informativ të urgjencës në rajonin e Piemonte-s/Itali dhe jo për implementim/instalim të sistemit të urgjencës. Për shkak të natyrës komplekse të objektit të kësaj procedure, duke qenë se ky objekt përmban:

- Blerje, furnizim dhe instalim pajisjesh hardware, (afërsisht 30% te Fondit Limit)
- Blerje, Implementim, instalim të software, (afërsisht 40% te Fondit Limit)
- Mirëmbajtje (SLA) (afërsisht 30% te Fondit Limit)

OE i cili merr përsipër zhvillimin e këtij projekti duhet të ketë patjetër kontrata të ngjashme të kësaj natyre në tre vitet e fundit siç kërkohet dhe në piken 2.2 të KVK në DST. Pra, Regola S.r.l duhet të kishte paraqitur kontrata të ngjashme edhe për objektin: implementim, instalim software.

2. Mungon deklarata e përmbushjes së specifikimeve teknike nga OE FBS Sh.p.k.

3. Mungon katalogu për specifikimet teknike të Laptop-it .

4. Dy konsulentët e deklaruar nga prodhuesi i SW, referuar pikës 7 në KVK të DST, nuk kanë dokumentuar përvojë në implementimin e sistemit të emergjencave civile, e provuar kjo dhe me deklaratën e bërë nga Prodhuesi (Regola S.r.l) ku deklaroi se konsulentët janë me përvojë në menaxhimin e software-it në fjalë. (*pranuar me rezervë ankesa lidhur me këtë shkak skualifikimi referuar vendimit nr. prot. 4246/8, datë 18.10.2016 të AK)

5. Vërtetimi i pagesës së tatimeve për kompaninë Regola S.r.l, i datës 14.09.2016 tregon se kjo kompani ka detyrime të ndryshme tatimore të pashlyera kundrejt organeve tatimore italiane.

Në DST shtojca 8 KPK pika 2 kërkohet:

1. Një dokument që vërteton se (subjekti juaj):
 - a) ka plotësuar detyrimet fiskale,
 - b) ka paguar të gjitha detyrimet e sigurimeve shoqërore , të lëshuar nga Administrata Tatimore.

Referuar vendimeve të KPP, përjashtohen nga detyrimet tatimore vetëm gjobat të cilat janë në proces ankimi, ndërsa detyrimet e tjera tatimore, pavarësisht faktit se mund të ekzistojë marrëveshje për shlyerjen me këste të tyre, do të konsiderohen detyrime të pashlyera. Për sa më lart, ky OE nuk plotëson këtë kërkesë për kualifikim.

6. Referuar marrëveshjes së bashkëpunimit mes 3 OE, rezultoi se përqindja e deklaruar e ndarjes së veprimtarive mes tyre është: Regola S.r.l - 53%, FBS Sh.p.k-22% dhe Communication Progress Sh.p.k- 25%.

Pas verifikimit dhe përlllogaritjes së vlerave për secilin aktivitet për çdo OE rezultoi se përqindja reale është: Regola S.r.l- 48% , FBS Sh.p.k -25% dhe Communication Progress Sh.p.k -27%.

Kjo gjë çënon besueshmërinë e OE lidhur me zbatimin e kontratës sepse nuk tregojnë realitetin për qëndrimin e aktiviteteve të cilat do të kryhen nga secili prej anëtarëve të BOE gjë e cila është e lidhur ngushtë edhe me përmbushjen e kritereve të tjera kualifikuese të përcaktuara në DST.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë **BOE “BETA 80 S.p.a & INFOTEAM S.r.l & REALCOM Sh.p.k”**, përfaqësuar nga Infoteam S.r.l (Massimo di Remiglio) Adresa: **Infoteam - Zyrë përfaqësimi në L. 8, Rr. “A. Goga”, Pall. 629, NIPT L42416503E**, se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej **194,110,290 (njëqind e nëntëdhjetë e katër milion e njëqind e dhjetë mijë dyqind e nëntëdhjetë) Leke pa TVSH** pikët totale të marra [_____] është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë *Qendra Kombëtare e Urgjencës Mjekësore, Laprakë Tiranë* sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentet e tenderit, brenda 5 ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj (nëse është kërkuar) dhe kontrata do t'i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej [vlera përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra], siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 10.10.2016

Ankesa: PO

(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë: 18.10.2016 dhe datë 20.10.2016

* * *

DREJTUESI I AUTORITETIT KONTRAKTOR

ILIR BEQAJ